

1. Fusha e transparencës dhe informimit të publikut

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është “Përmirësim i procesit të informimit të publikut nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies”

RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFAT I	AKTIVITETET	BURIMET	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2023	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2024	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2025
1. Infomacion jo i plotë dhe i natyrës teknike mbi procedurat dhe afatet e licensimit.	Publikimi i procedurave të licensimit, afatet dhe detyrimet e subjekteve në faqen e internetit në mënyrë sa më të thjeshtë dhe lehtësisht të kuptueshme nga publiku.	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave	Janar 2023	Përmirësimi i faqes së internetit si dhe kontraktimi i shërbimit TIK.	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave	Realizuar, është përditësuar faqa e internetit me aktet ligjore të miratuara	E realizuar: Është përditësuar faqa e internetit me të gjitha procedurat, afatet, shërbimet , formatet etj.(www.akshe.gov.al) Shërbimi TIK ka qënë i kontraktuar.	E realizuar: Është përditësuar faqa e internetit me të gjitha procedurat, afatet, shërbimet , formatet etj.(www.akshe.gov.al) Shërbimi TIK ka qënë i kontraktuar.
2. Mungesa e aktivteteve informuese me subjektet në tryeza të përbashkëta.	Organizimi i një aktiviteti / tryeze informative me subjektet e përfshira në fushën e përgjegjësisë së AKSHE-së	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës	Tetor 2024	Ekspertet e BE-se, EXBS, ambientet dhe krijimi i agendes	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës dhe Programet e Asistences se BE-se dhe EXBS	Planifikuar per 2024	AKSHE-ja është në komunikim me EXBS, për të oranzuar një aktivitet informues mbi procedurat e licensimit	E realizuar Janë zhvilluar takime dhe konsultime të vazhdueshme me subjektet e

					Departamenti i Shtetit			interesuara, në kuadër të procesit të konsultimit publik për hartimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e kontrollit të eksporteve.
3. Mungesa e raporteve kombëtare për vitet në vijimësi për transferimet e mallrave strategjike, hedhja e të dhënave të rregjistrit të subjekteve të licensuara, si dhe të aktiviteteve të AKSHE-së për interes publik dhe mediatik.	Përditësimi dhe publikimi në faqen Ëeb të raporteve kombëtare si dhe të rregjistrit.	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave	Maj 2024	Strukturimi i raporteve duke eliminuar pjesët konfidenciale dhe sekret tregtar, publikimi i tyre ne faqen Ëeb	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave	Në vitin 2023 është publikuar raporti Rajonal ku AKSHE-ja ka kontribuar për pjesën e transferimeve të mallrave ushtarake. Ky është raport publik; https://www.esac.org/Regional-Reports-on-Arms-Exports_1/	E realizuar: Raportet kombëtare për transferimet e mallrave strategjike janë përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare të AKSHE-së, duke mundësuar aksesin e publikut dhe subjekteve të interesuara në informacionin përkatës.	E realizuar: Raportet kombëtare për transferimet e mallrave strategjike janë përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare të AKSHE-së, duke mundësuar aksesin e

							https://www.akshe.gov.al/raportet-kombetare-dhe-rajonale/	publikut dhe subjekteve të interesuara në informacionin përkatës. https://www.akshe.gov.al/raportet-kombetare-dhe-rajonale/
4. Mungesa e trajnimeve për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.	Hartimi i një kurrikule trajnimi dhe trajnimi i stafëve të drejtorive që hartojnë akte ligjore dhe nënligjore lidhur me procesin e konsultimit publik.	Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës	Prill 2024	Trajnim i vazhdueshëm i koordinorit të njoftimit dhe konsultimit publik.	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik me mbështetjen e CIDS-së	Planifikuar për vitin 2024	Në pritje nga planifikimi i Ministrisë së Mbrojtjes për trajnimet konsultimit publik.	E realizuar : Nga ana e punonjesve të AKSHE është marrë pjesë aktive në trajnimet e realizuara nga Ministria e Mbrojtjes në lidhje me njoftimin

								dhe konsultimi n publik
5. Mungesa e trajnimit të rregullt në lidhje me antikorrupsionin dhe integritetin për të gjithë personelin.	Përfshirja e trajnimit për antikorrupsionin dhe integritetin, në planin vjetor të trajnimeve në bashkëpunim me MM	Drejtoria Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM dhe e legjislacionit dhe Licencave	Qershor 2024	Hartimi i një kurrikule trajnimi antikorrupsion/integritet.	Stafi i MM-së, Stafi i AKSHE-së me mbështetjen e CIDS-së	Planifikuar për vitin 2024	Në pritje nga planifikimi i Ministrisë së Mbrojtjes për trajnimet e antikorrupsionit dhe integritetit	Në pritje nga planifikimi i Ministrisë së Mbrojtjes për trajnimet e antikorrupsionit dhe integritetit

Gjatë periudhës raportuese, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) ka vijuar zbatimin e masave të parashikuara për fushën e transparencës dhe informimit të publikut, me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e llogaridhënies ndaj subjekteve dhe publikut të gjerë.

Në këtë kuadër, faqja zyrtare e institucionit (www.akshe.gov.al) është përditësuar vazhdimisht me procedurat, afatet, shërbimet dhe formatet e aplikimit, ndërkohë që janë përgatitur dhe publikuar raportet kombëtare mbi transferimet e mallrave strategjike, duke garantuar aksesin e publikut dhe të subjekteve të interesuara në informacionin përkatës. Paralelisht, janë zhvilluar takime dhe konsultime të vazhdueshme me subjektet e interesuara në kuadër të procesit të konsultimit publik për hartimin dhe miratimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e kontrollit të eksporteve, ndërsa punonjësit e AKSHE-së kanë marrë pjesë aktive në trajnimet e organizuara nga Ministria e Mbrojtjes mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

I vetmi element ende në pritje mbetet përfshirja e trajnimit të posaçëm për antikorrupsionin dhe integritetin në planin vjetor të trajnimeve, çështje që varet nga planifikimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe që do të ndiqet edhe gjatë periudhës në vazhdim.

2. Fusha e lëshimit të licensave dhe autorizimeve;

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *“Përmirësim i procesit të licensimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve procedurave transparente dhe ofrimin e shërbime online”*

Për fushën e lëshimit të licencave dhe autorizimeve, AKSHE ka ndërmarrë një sërë hapash konkretë drejt derregullimit, standardizimit dhe digjitalizimit të procedurave, me synim uljen e barrës administrative dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj subjekteve aplikuese.

RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFA TI	AKTIVITETET	BURIMET	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2023	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2024	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2025
1. Barra e larte administrative.	Zhvillimi i procesit të derregullimit me qëllim uljen e barrës administrative dhe qarkullimin e dokumentave online.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave	Dhjetor 2024	Rishikimi i procedurave ekzistuese. Evidentimi i dokumentave që rrisin barrën administrative për aplikime. Evidentimi i dokumentacionit i cili mund të merret nëpërmjet platformave ndërvepruese	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave	Ka filluar puna për derregullimin e shërbimeve që ofron AKSHE-ja në koordinim me Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë për Shtetin dhe Sipërmarrjen. Janë hartuar ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore që reflektojnë këtë reformë	Miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore që reflektojnë reformën e Derregullimit dhe Riinxhinerimit të Shërbimeve	E realizuar: Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) ka ndërmarrë hapa konkretë në kuadër të procesit të derregullimit. Në këtë kuadër, është miratuar VKM nr. 248, datë 30.04.2025, “Për përcaktimin e llojeve të licencave/certifikatave dhe autorizimeve, të dokumentacionit të aplikimit, formateve të kërkesave e të aplikimeve, si dhe të formateve të

								licencave, autorizimeve dhe certifikatave për transferimet ndërkombëtar e për mallra ushtarake dhe artikuj e teknologji me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve”. Miratimi i këtij akti ka kontribuar në standardizimin dhe thjeshtimin e dokumentacionit dhe procedurave të aplikimit, përcaktimin e qartë të dokumenteve dhe formateve përkatëse, si dhe në reduktimin e kërkesave administrative për subjektet
--	--	--	--	--	--	--	--	--

								që ushtrojnë veprimtari në fushën e transferimeve ndërkombëtar e të mallrave strategjike. Gjithashtu, në kuadër të procesit të derregullimit dhe digjitalizimit të shërbimeve, po punohet për rritjen e përdorimit të kanaleve elektronike për aplikimet dhe qarkullimin e dokumentacionit, me synim reduktimin e dokumentacionit fizik, shkurtimin e kohës së përpunimit dhe lehtësimin e ndërveprimit të subjekteve me AKSHE-në.
--	--	--	--	--	--	--	--	--

2. Përmirësimi i simeve online për aplikimet, duke ulur kontaktin me subjektet aplikuese.	Ngritja e nje sistemi online për aplikimet për licensa/autorizime.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës	Dhjetor 2024	Krijimi i softëare elektorik për e-licenca. Trajnimi i punonjësëve dhe subjekteve.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës Programet e Asistences se BE-se dhe EXBS Departamenti i Shtetit	Gjatë 2023 është krijuar sistemi i aplikimeve online , si dhe janë kryer disa testime	Gjatë vitit 2024 është konsoliduar sistemi i cili tashmë është lidhur edhe me e-albania. Sistemi aksesohet nëpërmjet faqes https://e-licenca.akshe.gov.al/	Në proces: Aktualisht, aplikimet për shërbimet përkatëse realizohen nëpërmjet platformës e-Albania, duke mundësuar paraqitjen elektronike të kërkesave dhe dokumentacionit nga subjektet aplikuese dhe duke reduktuar nevojën për paraqitje fizike dhe kontakt të drejtpërdrejtë me administratën. Në vijim të këtij procesi, AKSHE është në proces të vendosjes dhe funksionalizimit të sistemit

								të e-licencimit, i cili synon të automatizojë më tej procedurat e aplikimit, shqyrtimit dhe administrimit të dokumentacionit. Ky proces do të kontribuojë në rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe eficiencës së shërbimeve, si dhe në minimizimin e kontakteve të panevojshme ndërmjet subjekteve dhe administratës.
3. Lëshimi i licensave / autorizimeve në afatet e përcaktuara në legjislacion.	Krijimin e sistemeve elektronike të monitorimit të afateve	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e	Dhjetor 2024	Krijimi i softëareve elektronik për e-licenca. Trajnimi i	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit	Gjatë 2023 është krijuar sistemi i aplikimeve online, si dhe	Gjatë vitit 2024 është konsoliduar sistemi i cili tashmë është	E realizuar: AKSHE ka vijuar të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme

		Inspektimit dhe Analizës		punonjësëve dhe subjekteve.	dhe Analizës Programet e Asistences se BE-se dhe EXBS Departamenti i Shtetit	janë kryer disa testime.	lidhur edhe me e-albania. Sistemi aksesohet nëpërmjet faqes https://e-licenca.akshe.gov.al/	respektimin e afateve ligjore për shqyrtimin dhe përfundimin e procedurave të licencimit dhe autorizimit. Nga monitorimi i të dhënave në SQDNE rezulton se nuk ka raste të licencave apo autorizimeve të pa trajtuara Procedurat janë administruar dhe përfunduar brenda afateve përkatëse ligjore. Nga 536 aplikime, 0 janë të pa trajtuara, 34 janë trajtuar jashtë afatit , 495 janë
--	--	--------------------------	--	-----------------------------	--	--------------------------	--	--

								trajtuar brenda afateve, 7 jane ne proces trajtimi
4. Mungesa e një plani vjetor trajnimesh i cili buron nga vlerësimi i nevojave për trajnime në fushën e procedurave të licensimit.	Hartimi i planit vjetor për trajnime.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës	Qersh or 2024	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave finalizon planin vjetor për trajnime.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës	Planifikuar për vitin 2024 AKSHE-ja ka marrë pjesë në 12 Aktivitetete kombëtare/rajo nale	Gjatë vitit 2024 është kërkuar asistencë nga programi EU P2P i Bashkimit Europian për hartimin e disa kurrikulave trajnimi për punonjësit e licensimit. Është duke u finalizuar dhe plani i trajnimeve të përbashkëta me ekspertët e BE-së. AKSHE-ja ka marrë pjesë në 12 Aktivitetete kombëtare/rajon ale	E realizuar; Nga ana e AKSHE jane evidentuar kerkesat te cilat parashikojne zhvillimin e aktiviteteteve trajnuese për stafin, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative , lidhur me procesin e licensimit. Gjate periudhes raportuese stafi ka marre pjese active neper trajnime kombetare dhe nderkombetar e sipas tabelës

								bashkelidhur raportit. AKSHE-ja ka marrë pjesë në 12 Aktivitetete kombëtare/rajonale
--	--	--	--	--	--	--	--	---

Në këtë drejtim, është miratuar VKM nr. 248, datë 30.04.2025, e cila standardizon dokumentacionin dhe procedurat e aplikimit për licencat, autorizimet dhe certifikatat për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë. Aplikimet realizohen tashmë nëpërmjet platformës e-Albania, ndërsa AKSHE është në proces të funksionalizimit të plotë të sistemit të e-licencimit, që synon automatizimin e mëtejshëm të shqyrtimit dhe administrimit të dokumentacionit. Monitorimi i afateve ligjore tregon një nivel të lartë përmbushjeje: nga 536 aplikime të trajtuara, 495 janë përfunduar brenda afatit, 34 jashtë afatit dhe vetëm 7 mbeten në proces trajtimi, ndërsa stafi i drejtorive përkatëse ka vijuar pjesëmarrjen në trajnime kombëtare dhe rajonale në kuadër të planit vjetor të kapaciteteve.

ANEKS 1 – AKTIVITETET E AKSHE-së (2023–2025)

Ky aneks përmban listën e aktiviteteve konkrete (takime, konferenca, seminare, trajnime ndërkombëtare) në të cilat AKSHE ka marrë pjesë gjatë periudhës 2023–2025, referuar në kuadër të Masës 1.4 dhe masave të tjera të Planit të Integritetit që lidhen me aktivitetet informuese dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Aktivitetet AKSHE 2023

Nr.	Data	Vendi organizator	Aktiviteti	Pjesëmarrës
1	30 janar - 02 shkurt	Bruksel, Belgjikë.	Kapitullin 1 "Lëvizja e lirë e mallrave. Org BE	AKSHE
2	08 - 09 shkurt	Wiesbaden, Gjermani	-	AKSHE
3	28 shkurt – 2 mars	Bukuresht, Rumani	COARM Outreach Project V, Org BAFA	AKSHE
4	14-16 mars	Bruksel, Belgjikë	Seminari Ndër rajonal mbi Catch-all Controls. Org . Bashkimit Europian dhe EXBS .	AKSHE
5	15-17 mars	Chiba, Japoni	Konferencën për mbrojtjen dhe sigurinë.Org. EXBS	AKSHE

Nr.	Data	Vendi organizator	Aktiviteti	Pjesëmarrës
6	19.21 shtator	Zagreb, Kroac	Nisma Rajonale e Bashkëpunimit mbi sigurinë Nukleare” Org. RACVIAC	AKSHE
7	27 prill - 5 maj	Uashington-Cikago, USA	zbatimin e sanksioneve dhe kontrollin e eksporteve. Org.	AKSHE
8	13 – 14 qershor	Algjer, Algjeri	Sem. Ndër rajonal. EU COARM Outreach Project V	AKSHE
9	21 – 22 qershor	Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë	Takim me qëllim përmirësimin e kontrollit të eksporteve për mallrat dual-use dhe përshtatjen e legjislacionit me atë të BE-së. Org.BE	AKSHE
10	21-25 gusht	Gjenevë, Zvicër	Konferenca e 9-të e Shteteve Anëtare (CSP9). Org ATT	AKSHE
11	06 – 07 shtator	Tallinn, Estoni	Trajnimin mbi sistemin e licencimit . Org EXBS	AKSHE
12	27-28 nentor	Bruksel, Belgjikë	Takim në kuadër të programeve EU COARM Outreach Project V	AKSHE

Aktivitetet AKSHE 2024

Nr.	Data	Vendi organizator	Aktiviteti	Pjesëmarrës
1	26-27 mars	Zagreb, Kroaci	Nisma Rajonale e Bashkëpunimit mbi Sigurinë Nukleare, Org. RACVIAC	AKSHE
2	15-16 maj	Jahorin, Bosnje	Takim në kuadër të programeve EU COARM Outreach Project V	AKSHE
3	03-07 qershor	Zagreb, Kroaci	Rrugët e përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë, Org. RACVIAC	AKSHE
4	20 - 21 qershor	Talin, Estoni	Konferencën e zhvilluar në kuadër të programeve të EXBS për përdoruesit e Stratlink (e-Licesing	AKSHE
5	01-03 korrik	Bruksel, Belgjikë	për Kapitullin e 18-të 2021/555 dhe 20-të 258/2012 të rregullores (EU). Or. EU	AKSHE
6	09 - 11 korrik	Podgoricë, Mal i Zi	takimet 11-të dhe 19-të për Udhërrëfyesin dhe Kontrollin për armët e vogla dhe të lehta, në Ballkanin Perëndimor	AKSHE
7	08-12 korrik	Budapest, Hungari	takimi i 10-të (shkolla verore) t mbi “Kontrollet strategjike të mallrave me përdorim të dyfishtë. EU P2P	AKSHE
8	18-24 gusht	Gjenevë, Zvicër	Konferenca për ATT	AKSHE
9	08 – 09 tetor	Bruksel, Belgjikë	takimi i katërt për kontrollin e dual-use dhe programet e pajtueshmërisë së brendshme për kompanitë. Org EU P2P	AKSHE

Nr.	Data	Vendi organizator	Aktiviteti	Pjesëmarrës
10	21-22 tetor	Bruksel, Belgjikë	Seminarin rajonal mbi harmonizimin e legjislationit. Org SEESAC	AKSHE
11	20-22 nëntor	Hage, Holandë	takimi i 26-të i Autoriteteve Kombëtare. Org OPCW	AKSHE
12	04-05 dhjetor	Sarajevë, Bosnje	Promovimin e kontrollit efektiv të eksporteve të armëve konvencionale. Org. Bafa	AKSHE

Aktivitetet AKSHE 2025

Nr.	Data	Vendi organizator	Aktiviteti	Pjesëmarrës
1	23-28 shkurt	Gjeneve, Zvicer	Takimi i 11-të i shteteve palë në Traktatin e Tregëtisë së Armëve (ATT)	AKSHE
2	07-09 prill	Prishtinë, Kosovë.	Identifikimin e MPD. Org.BAFA në kuadër të programit EUP2P	AKSHE
3	08-10 prill	Split, Kroaci	Mospërhapja, Armë Kontrolli dhe Çarmatimi. Org.RACVIAC	AKSHE
4	14-16 prill	Lubjane, Slloveni	Nisma e sigurisë së përhapjes. Org Slloveni dhe SHBA	AKSHE
5	07-09 maj	Beograd, Serbi	Konferencë e përbashkët (programi COARM VII). Org BAFA	AKSHE
6	14-16 maj	Kotorr, Mal I Zi	Takimin rajonal mbi zbatimin e kodit ndërkombëtar për mallrat e rrezikshme detare (IMIDG). Org. TAIEX	AKSHE
7	11-13 qershor	Bukuresht, Rumani	Përmirësimi i kapaciteteve kundër përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë, Org. RACVIAC	AKSHE
8	11-12 qershor	Jerevan, Armeni	Takimin e 26 rajonal të shteteve të EL palë e Konventës së Armëve Kimike. Org OPCW	AKSHE
9	17-20 qershor	Shangai, Kinë	Përdorimi i Inteligjencës Artificiale për Menaxhimin e Sigurisë dhe Mbrojtjen Kimike. Org OPCW	AKSHE
10	07-11 korrik	Kopenhagen, Danimarkë	Universitetin Veror të BE për Kontrollin e Mallrave me Përdorim të Dyfishtë. Org EUP2P	AKSHE
11	23-25 shtator	Hage, Hollande	Seminarin tre-ditor të OPCW-së .	AKSHE
12	02-03 tetor	Vjeë, Austri	Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Org SEESAC / UNDP / OSBE	AKSHE

3. Fusha e inspektimeve.

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “Përmirësim i procesit të inspektimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve procedurave transparente dhe ofrimin e shërbime online”

RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËS E	AFAT I	AKTIVITETET	BURIMET	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2023	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2024	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2025
1. Mungesa e Planit vjetor të inspektimeve.	Hartimi i Planit vjetor të inspektimeve dhe metodologjisë për inspektime rastësore.	Drejtoria Inspektimit dhe Analziës	Dhjetor 2024	Drejtoria Inspektimit dhe Analziës finalizon planin vjetor për trajnime.	Drejtoria Inspektimit dhe Analziës	Planifikuar për vitin 2024	Realizuar: Plani Vjetor i Inspektimeve është hartuar dhe miratuar, duke përcaktuar subjektet dhe fushat që do të jenë objekt i inspektimeve gjatë periudhës përkatëse, në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedurat në fuqi.	Realizuar: Plani Vjetor i Inspektimeve është hartuar dhe miratuar, duke përcaktuar subjektet dhe fushat që do të jenë objekt i inspektimeve gjatë periudhës përkatëse, në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedurat në fuqi.
2. Mungesa e trajnimeve mbi procesin e inspektimit në subjekte dhe pika doganore.	Përfshirja e trajnimeve të inspektorëve mbi procedurat e inspektimit.	Drejtoria Inspektimit dhe Analziës	Dhjetor 2024	Organizimi dhe pjesëmarrja në trajnime specifike në lidhje me procedurat e inspektimit.	Drejtoria Inspektimit dhe Analziës	Planifikuar për vitin 2024	Gjatë vitit 2024 është kërkuar asistencë nga programi EU P2P i Bashkimit Europian për hartimin e disa kurrikulave	E realizuar Janë zhvilluar aktivitete trajnuese dhe informuese lidhur me procedurat e inspektimit në

							trajnimi për punonjësit e inspektimit. Është duke u finalizuar dhe plani i trajnimeve të përbashkëta me ekspertët e BE-së.	subjektet e licencuara dhe në pikat doganore, me fokus në zbatimin e kërkesave ligjore, mënyrën e kryerjes së kontrolleve dhe dokumentimin e gjetjeve.
3. Përmirësimi i sistemit të raportimit nëpërmjet mjeteve elektronike me qëllim uljen e barrës inspektuese dhe numrit të inspektimeve.	Krijimin e sistemeve elektronike të raportimeve nga subjektet	Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës, Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave	Dhjetor 2024	Krijimi i softëareve elektronik për raportimet e subjekteve.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës Programet e Asistencës së BE-së dhe EXBS Departamenti i Shtetit	Gjatë 2023 është krijuar sistemi i aplikimeve online, si dhe janë kryer disa testime. Ky sistem ka të integruar edhe modulën e raportimeve.	Gjatë vitit 2024 është konsoliduar sistemi i cili tashmë është lidhur edhe me e-albania. Sistemi aksesohet nëpërmjet faqes https://e-licenca.akshe.gov.al/	Në proces: Në këtë kuadër, është planifikuar që, me vënien në funksionim të faqes/sistemit të dedikuar për procesin e licencimit, të mundësohet edhe raportimi dhe administrimi elektronik i informacionit dhe dokumentacionit të subjekteve. Kjo do të

								krijojë mundësi për mbledhjen dhe verifikimin e informacionit në mënyrë elektronike, duke reduktuar nevojën për kërkesa të përsëritura për dokumentacion dhe kontaktet fizike me subjektet.
--	--	--	--	--	--	--	--	---

Në fushën e inspektimeve, AKSHE ka hartuar dhe miratuar Planin Vjetor të Inspektimeve, duke përcaktuar subjektet dhe fushat objekt inspektimi në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe ka organizuar aktivitete trajnuese e informuese për stafin inspektues mbi procedurat e inspektimit në subjektet e licencuara dhe në pikat doganore.

Në vazhdim të këtij procesi, institucioni është në proces të krijimit të një sistemi elektronik për raportimin nga subjektet, i cili do të integrohet me sistemin e e-licencimit dhe do të mundësojë administrimin elektronik të informacionit, duke reduktuar kërkesat e përsëritura për dokumentacion dhe kontaktet fizike me subjektet.

4. Fusha e menaxhimit financiar.

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *“Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik”*
Për fushën e menaxhimit financiar, AKSHE ka ndërmarrë masa për forcimin e transparencës dhe të mirëadministrimit të burimeve dhe aseteve institucionale, në funksion të uljes së risqeve të lidhura me procesin e prokurimit publik.

RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËS E	AFAT I	AKTIVITET I	BURIMET	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2023	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2024	STATUSI I REALIZIMIT PËR 2025
1. Mungesa e trajnimeve për koordinatorin e riskut.	Pjesëmarrja në trajnime e koordinatorit të riskut.	Koordinatori i riskut	Prill 2024	Trajnime të koordinatorit të riskut.	Koordinatori i riskut	Planifikuar për vitin 2024	Në pritje nga planifikimi i Ministrisë së Mbrojtës për trajnimet e Koordinatorit të Rriskut	Në proces: Trajnimet përkatëse do të përfshihen në planifikimin e aktiviteteve trajnuese të institucionit dhe do të zhvillohen në vijim, në përputhje me nevojat e identifikuara dhe mundësitë e ofruara nga institucionet përgjegjëse.
2. Mungesa e rregullave të veçanta për mirëadministrimin e aseteve dhe materialeve.	Përfshirja e rregullave për rotacionin e stafit, në rregulloren e brendshme të institucionit.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave	Prill 2024	Hartimi i rregullave të posaçme për rotacionin e stafit gjatë procedurat me risk të tilla, si	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave	Planifikuar për vitin 2024	Hartimi i procedurave është proces. Janë kryer rotacionet e stafit mbi personat që	Në proces: Në këtë kuadër, janë miratuar urdhra për administrimin dhe mirëmenaxhimin e aseteve dhe

				prokurimet publike.			marrin pjesë në KVO	materialeve, të cilët përcaktojnë përgjegjësitë dhe mënyrën e administrimit të tyre. Gjithashtu, me qëllim institucionalizimin dhe unifikimin e këtyre rregullave, parashikohet që procedurat dhe rregullat për mirëadministrimin e aseteve dhe materialeve të përfshihen në Rregulloren e Brendshme të Institucionit.
3. Mungesa e transparencës për të gjithë dokumentacionin e hartuar për procesin e prokurimit publik.	Përditësimi i programit të transparencës.	Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës, Sektori i Financës dhe Burimeve mbështetëse	Shkurt 2024	Publikimi në programin e transparencës i regjistrit të parashikimeve dhe regjistri i realizimeve të	Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës Sektori i Financës dhe burimeve mbështetëse	Planifikuar për vitin 2024	Realizuar: Publikuar në faqen e Autoritetit	Realizuar: AKSHE ka marrë masat e nevojshme për rritjen e transparencës dhe aksesit të publikut në informacionin

				prokurimeve publike.				lidhur me proceset e prokurimit publik. Dokumentacioni dhe informacioni përkatës lidhur me procedurat e prokurimit publik është publikuar në faqen zyrtare të institucionit, në përputhje me kërkesat ligjore për transparencën dhe publikimin e informacionit.
--	--	--	--	-------------------------	--	--	--	---

Në këtë kuadër, janë miratuar urdhra të brendshëm për administrimin dhe mirëmenaxhimin e aseteve dhe materialeve, ndërsa parashikohet përfshirja e këtyre rregullave në Rregulloren e Brendshme të Institucionit. Gjithashtu, dokumentacioni dhe informacioni lidhur me procedurat e prokurimit publik publikohet rregullisht në programin e transparencës në faqen zyrtare të institucionit. Mbetet ende në proces trajnimi i koordinаторit të riskut, i cili do të përfshihet në planifikimin e ardhshëm të aktiviteteve trajnuese të institucionit.